

# RELACION TEKNIK

## “Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare Sevasti Qiriazhi”

### KORÇË



## ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

Shkolla “Sevasti Qiriazhi” ndahet në dy struktura të cilat janë ndërtuar në kohë të ndryshme. Struktura e parë është ndërtuar në vitet 1881, si një nga godinat kryesore të arsimit në Korçë. Arkitektura e godinës përfaqëson një objekt 2 katësh arsimor, me mure guri, dhe një monoton tek çarrjet e fasadës. Struktura e dytë është ndërtuar rreth viteve 2012. Ajo është 3 kate dhe ka konstruksion beton-arme. Dy strukturat bashkohen tek një nga faqet duke krijuar në planimetri një formë të shkronjës L. Lëvizja nëpër të dyja hapësirat kryhet nëpërmjet një tuneli në katin e parë. Oborri i shkollës ndodhet paralel me rrugën “Alqi Kondi” duke patur akses nga rruga duke kaluar me kishën “Shën Harallambi”.

Përgjatë kohës, shkolla ka pësuar restaurime të vazhdueshme, duke humbur karakteristikat arkitektonike fillestare. Ndër to, mund të përmendet termoizolimi i shkollës i cili ka çuar në veshjen e mureve të gurit.




### Analiza e ambienteve të shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qiriazhi”

Ambjentet e brendshme të shkollës janë të degraduara dhe me bazë materiale të vjetëruar duke krijuar hapësira jokomode për mësim. Problematikat aktuale janë:

1. Dritaret janë vjetëruar dhe nuk mundësojnë plotësisht izolimin e temperaturës.
2. Ndriçimi i të gjitha ambienteve është jashtë standarteve dhe me kapacitet të ulët.
3. Dyert janë të amortizuara.
4. Dyshemeja ka pësuar dëmtime.
5. Baza materiale (banka, karrike, dollapë etj) nuk është në gjendje të mirë.
6. Sistemi i tubacioneve ka pësuar dëmtime, e cila sjell rrjedhje të ujit nëpër mure.
7. Shkallët nuk janë të sigurta për përdoruesit e moshave të vogla.
8. Fasada e shkollës ka dëmtime dhe ndotje.

9. Oborri duhet të shtrohet në një nivel dhe të pajiset me ujë kulluesa.
10. Kangjellat e dritareve të katit përdhe janë të amortizuara dhe të pasigurta.
11. Tualetet janë të vjetëra dhe me kloseta të stilit “allaturka”.
12. Sistemi i shpërndarjes së ujit ka pësuar dëmtime duke rrjedhur ujë nëpër mure.
13. Kërkohen ambjente të reja për klasa laboratorike dhe depo
14. Përmirësimi i ndriçimit të ambjenteve.















## Rikonstruksioni

Me ndërhyrjen e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qiriazhi” synohet përmirësimi i ambjenteve dhe kushteve të godinës dhe zgjatja e jetëgjatësisë së saj. Është e nevojshme që me ndryshimin e teknologjisë dhe kurrikulave mësimore, të shtohen klasat laboratorike dhe pajisja e klasave me video-projektor.

Fasada e shkollës do të lyhet me bojë për amjente të jashtme, duke evidentuar funksionin dhe stilin arkitektonik të godinës. Oborri do të shtrohet me në një nivel, dhe në qendër të tij do të shtohet një fushë volejboli e hapur. Shkallët dhe rampa të cilat aktualisht ndodhen në ambjentet e brendshme të godinës, do të ndërtohen në oborr duke garantuar siguri dhe komfort në lëvizje. Muret e korridoreve do të vishen me panele drurori ne nivel 100 cm nga dyshemeja për mbrojtje dhe estetikë. Tavanani do të ulet me tavan të varur gipsi tek i cili do të vendosen ndriçuesat LED. Tualetet e katit përdhe tek godina e vjetër do të ndryshohen dhe do të shtohen dy çifte tualetesh në katin e parë. Të gjitha klasat do të kenë tavan të varur dhe ndriçuesat LED. Faqja e murit tek e cila do të varet dërrasa e zezë, do të vishet me pllaka përgjatë gjithë gjatësisë së saj me lartësi 90 cm nga dyshemeja. Dyshemeja e shkollës do të ndërrohet duke u veshur me pllaka dhe parket sipas funksionit të çdo ambjenti. Shkallëve do tu ndryshohen parrakët. Tualetet e shkollës së re do të zhvendosen dhe do të pajisen me hidrosanitare të reja. Tek kati përdhe i godinës së re, do të vendosen laboratoritë bashkë me bibliotekën e cila do të ketë një faqe me vetratë, laboratoritë e gjuhëve të huaja, salla e baletit dhe palestra.

Dritaret dhe dyert e gjithë godinës do të zëvendësohen duke u mbështetur standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare.



